



Pranuar / Dorezuar Punëhetor/Prodator Received/Deliverty	09.04.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Printog Appendix	Sasia Koliciana Quantity
SKIMSHICK	3296/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.369/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.369/2023 të datës 16.02.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit-Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.369/2023 e datës 16.02.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Nëpunësi Civil i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, më datë 21.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1855/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me shkrim të datës 18.01.2023 të organit të punësimit/Zyrës së Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut lidhur me refuzimin e kërkesës së ankueses për shtesat mbi pagën bazë për kushtet specifike të punës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës së pagesës shtesë mbi pagën bazë sipas legjislacioni i veçantë Ligji Nr. 04/L-186 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-181 Për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 21.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Ndërsa Këshilli, me datë 20.03.2023 përmes emailit ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1855/2023 të datës 06.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut; Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt Emërimit të datës 30.11.2022; Zarfën postar me shifër R2719860; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 21.02.2023; E-mailin e datës 13.03.2023 dërguar nga B.S për Këshillin me shkresat e bashkëngjitura të lëndës; Kërkesën e ankuesit të datës 21.12.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Inspektor i Tregut.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe duke marrë për bazë legjislacionin përkatës që rregullon këtë natyrë të kësaj çështje, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi në bazë të Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 30.1.2022 është i punësuar në pozitën "Inspektor i Tregut" në Komunën e Mitrovicës. Tutje sipas shkresave i njëjti më datë 21.12.2022 i është drejtuar Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me kërkesën për miratimin e pagesës "Shtesat mbi pagën bazë për kushtet specifike të punës" duke iu referuar nenit 10.A të Ligjit Nr.04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut i cili ishte në fuqi nga data 15.05.2013, sikurse përcaktohet: "1. Inspektorëve të tregut i njihet e drejta e marrjes së pagesës shtesë mbi pagën bazë, për shkak të kushteve specifike në punë 2. Shtesat sipas paragrafit 1. të këtij neni do të bëhen konform Ligjit përkatës për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjit përkatës për pagat e nëpunësve civil", ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me datë 18.01.2023 i ka kthyer përgjigje duke ia refuzuar kërkesën.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon për kompensimin e shtesën mbi pagën bazë për kushtet specifike të punës sipas Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet e Tjera të Nëpunësve Civil dhe legjislacionit të veçantë për inspektoratin e mbikëqyrjes së tregut.

Lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, si dhe duke marrë parasysh se pretendimet ankimore të ankuesit që kanë për objekt çështjen e kompensimit të shtesën mbi pagën bazë për kushtet specifike të punës sipas Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet e Tjera të Nëpunësve Civil dhe legjislacionit të veçantë për inspektoratin e mbikëqyrjes së tregut, Kolegji i Këshillit konstaton se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datë 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 Janar 2023, dhe si rrjedhojë i njëjti ka hyrë në fuqi më datë 05.02.2023, ndërsa me nenin 45 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe paragrafi 2 ka përcaktuar se: "1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet: 1.1.Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, 2. Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës,

kompensimeve, shitesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji" ndërlidhur me nenin 12 të Rregullores Nr.08/2022 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik ku parashihet se: "Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë si dhe çdo akt nën-ligjor dhe dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë rregullore.", prandaj sikurse u theksua si më lartë, Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregullorja Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet e Tjera të Nëpunësve Civil mbi bazën e të cilave ankuesi kërkon që t'i aprovohet shtesa në pagë tani më janë shfuqizuar dhe mbi këtë bazë ligjore pretendimi ankimor i ankuesit është i pamundur ligjërisht, ndërsa dispozita e nenit 10.A e Ligjit Nr.04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut tani më mund të gjejë zbatueshmëri vetëm sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me dispozitat e reja ligjore të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të shkresave kryesore që lidhen me pretendimin e ankueses analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ku në nenin 2 paragrafi 1 dhe 2 në lidhje me fushëveprimin e kësaj fushe parasheh: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit,; 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", ndërsa në nenin 22 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 i këtij ligji parasheh: "1. Shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.4. shtesa për kushte specifike të punës", ndërlidhur me nenin 26 paragrafi 1, 4 dhe 5 ku përcaktohet se : "1. Shtesa për kushte specifike të punës përfitohet nga zyrtaret/ët publik dhe të punësuarat/it e tjerë që janë të ekspozuar ndaj rrezikshmërisë në vendin e punës ose kanë kushte specifike të punës që ua rrezikojnë jetën dhe/apo shëndetin...; 4.Me rastin e krijimit të funksioneve, pozitive, apo emërtesat e reja sipas nenit 42 të këtij ligji, institucioni në të cilin krijohet pozita, kur e vlerëson se kësaj pozite duhet ti takoj shtesa për kushte specifike të punës, kërkon nga ministria përgjegjëse për administratën publike dhe ministria përgjegjëse e financave pëlqimin për përfitim të kësaj shtese. 5. Pozitat përkatëse për të cilat përfitohet shtesa për kushte specifike të punës, vlera dhe procedura për përfitimin e saj miratohen me akt nënligjor nga Qeveria pas propozimit nga ministria përgjegjëse për financa", nga rrjedh se mënyra, gjegjësisht procedura dhe kushtet e tjera që lidhen me përfitimin e kësaj shtese rregullohen me dispozitat e aktit nën ligjor të këtij ligji.

Kolegji i Këshillit, me rastin e objektin e kësaj ankese ka konstatuar se tashmë Qeveria e Republikës së Kosovës më datë 06.02.2023 ka nxjerrë Rregulloren (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, në nenin 1 sa i përket qëllimit të kësaj rregullore e njëjta parasheh: "1. Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë kriteret, kushtet, rregullat, mënyrën e llogaritjes dhe procedurën për përfitimin e shtesave të mëposhtme për të punësuarit në sektorin publik:" 1.4.shtesa e kushteve specifike të punës.....,etj", ndërsa në nenin 7 paragrafi 1, 2, 5, 6 dhe 7 të së njëjtës rregullore sa i përket procedurës për përfitimin e shtesës për kushte specifike të punës, parasheh: "1. Secili institucion që vlerëson se ka zyrtarë publikë dhe të punësuar të tjerë që plotësojnë kriteret për të përfituar këtë shtesë dorëzon kërkesën për miratim të shtesës për pozitat përkatëse tek Komisioni sipas paragrafit 2 të këtij neni...; 2. Kërkesa sipas paragrafit 1, dorëzohet tek Komisioni i cili themelohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me mandat tre (3) vjeçar...; 5. Me nxjerrjen e raportit përfundimtar, Komisioni dërgon të njëjtin për miratim në Qeverinë e Republikës së Kosovës. 6. Qeveria, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria përgjegjëse për financa, miraton të gjeturat e Komisionit përmes vendimit qeveritar; 7. Komisioni, në çdo

kohë dhe në bazë të kërkesës së institucioneve, mund të rishikojë listën e aprovuar në Qeveri dhe të propozojë ndryshimin e saj'', andaj Kolegji i Këshillit bazuar në dispozitat e lartshënuara të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publikë, konstaton se përderisa nuk respektohen procedurat sipas kësaj rregullore brenda institucioneve përkatëse të pasqyruara si më lartë dhe se çdo veprim, duke përfshirë edhe kërkesat e natyrës financiare apo ankesat e parashtruara në Këshill që lidhen me çështjet që këto dispozita i rregullojnë pa ndjekur procedurat që i parasheh ky ligj janë të parakohshme, ngase në rastin konkret nuk kemi akt administrativ që ua mohon një të drejtë të pretenduara nga Komisioni kompetent i përcaktuar sipas nenit 7 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik.

Prandaj, në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit konstaton së ankesa A.nr.369/2023 e datës 16.02.2023 e parashtruar nga ankuesi është e papranueshme në rastin konkret, rrjedhimisht e njëjta është hedhur poshtë si e palejuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që në rastin konkret nuk janë ndjekur procedurat ligjore sikurse përcaktohet shprehimisht me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik.

Hedhja poshtë e kësaj ankese, palës ankuese në të ardhmen nuk ia mohon të drejtën e parashtrimit të ankesës lidhur me realizimin e shtesës në pagë për kushteve specifike të punës, mirëpo vetëm pasi të shteren veprimet institucionale sikurse parashikohet me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.369/2023

Flakron GASHI

Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetari të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut, dhe
- Arkiviot të KPMSHCK-së